



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 43, datë 28.04.2017

PËR

**MIRATIMIN E AGJENTËVE NË SIGURIME,
NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT “ALBSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 199, pika 2, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, me propozim të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime të Jo-Jetës, të Z. Ronald Cenaj dhe Z. Kastriot Toska, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit “Albsig” sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI